



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**VENDIM**

**Nr. 209/1, datë 30.6.2020**

**Mbi korrigjimin e gabimeve materiale në vendimin nr. 209, datë 11.11.2019**

Sot, më 30.6.2020, trupi gjykues, i përbërë nga:

<b>Firdes Shuli</b>	Kryesuese
<b>Alma Faskaj</b>	Relatore (në mungesë)
<b>Pamela Qirko</b>	Anëtar

bazuar në nenin 112, të Kodit të Procedurave Administrative: “Korrigjimi i gabimeve materiale në aktin administrativ”, sipas të cilit përcaktohet se:

- “1. Organi publik, në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korrigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përlllogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ.*
- 2. Organi publik ka të drejtë të kërkojë kthimin e aktit administrativ të shkruar që korrigjohet, si dhe të çdo kopje të njëzuar të tij”*,

u mblodh për t’u njohur me kërkesën e kryesueses së trupit gjykues, znj. Firdes Shuli, për korrigjimin e një gabimi material në vendimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Hjarie Muçmata, me nr. 209, datë 11.11.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në f. 3, në paragrafin I - Rrethanat e çështjes, pika 13 e tij, ku parashikohet shprehimisht: *“Trupi gjykues, i ngritur me vendimin nr. 33, datë 27.5.2019, lidhur me kërkesën e subjektit për përjashtimin e trupit gjykues, në vendimin e tij ndër të tjera arsyetoi: ‘Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ushtron funksionet e tij si institucion i pavarur dhe i paanshëm, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor, në përputhje me Kushtetutën, Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut si dhe ligjin nr. 84/2016”*.

Në këtë paragraf, duhet të korrigjohet nr. 33 dhe data 27.5.2019, të vendimit, i cili rezulton të jetë një *lapsus*. Konkretisht, shprehja “me vendimin nr. 33, datë 27.5.2019”, duhet të korrigjohet duke u shkruar “me vendimin nr. 54, datë 28.10.2019”.

Pas verifikimit, u konstatua se kërkesa e kryesueses qëndron, pasi vendimi në të cilin trupi gjykues i shortuar për të shqyrtuar kërkesën e subjektit të rivlerësimit, znj. Hjarie Muçmata, për përjashtimin e trupit gjykues nga procesi i saj i rivlerësimit, gabimisht është shënuar me nr. 33, datë 27.5.2019, pasi ky vendim është me nr. 54, datë 28.10.2019. Pasaktësia është dukshëm si pasojë e një gabimi material, në faqen nr. 3 të vendimit përfundimtar të subjektit të rivlerësimit, znj. Hjarie Muçmata, paragrafi “I - Rrethanat e çështjes”, pika 13 e tij.

Për këto arsye, trupi gjykues, në mungesë të komisioneres Alma Faskaj për shkak të mungesës objektive për arsye shëndetësore.

## **V E N D O S I:**

1. Korrigjimin e një gabimi material në faqen nr. 3 të vendimit nr. 209, datë 11.11.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në paragrafin “I - Rrethanat e çështjes”, pika 13 e tij, ku shprehja “ me vendimin nr. 33, datë 27.5.2019”, të korrigjohet dhe të zëvendësohet me shprehjen “me vendimin nr. 54, datë 28.10.2019”.
2. Njoftimin e subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe Vëzhguesit Ndërkombëtar për këtë korrigjim.
3. Vendimi i korrigjuar të publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Firdes SHULI**  
**Kryesues**

**Pamela QIRKO**  
**Anëtar**

**Alma FASKAJ**  
**Relator/në mungesë**

*Sekretare gjyqësore*  
*Denisa Kosta*